



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS  
THE UNION OF INDEPENDENT TRADE UNIONS OF KOSOVA

Adresa:Rr."Nëna Terezë" 35, 10 000 PRISHTINË,  
Tel/fax:++381(0)38 229 838, e-mail:bspk@etuc.org



### **U mbajt Kuvendi II Zgjedhor i Rrjetit të Gruas (RrG) të BSPK-së,**

**Prishtinë, 10 dhjetor** - Në bazë të vendimeve të Këshillit Drejtues të BSPK-së të dt.7 tetor 2010, Komisioni për përgatitjen dhe organizimin e Kuvendit Zgjedhor të BSPK-së kishte caktuar 30 nëntorin si datë të mbajtjes së Kuvendit II Zgjedhor i Rrjetit të Gruas (RrG) të BSPK-së. Kuvendi në fjalë u mbajt në datën e lartpërmendur në lokalet e Qendrës së Studentëve në Prishtinë, ndërsa në punimet e tij muarrën pjesë 62 delegate nga 73 sa ishin caktuar nga SP-të, që përfaqësonin anëtarësinë e grave sindikaliste të: SBASHK-ut (29 delegate); FSSHK-ja (26); SPK-ja (11); SPJK (3), SPVKBK (2) dhe SPAGK (2 delegate). Kryetari i BSPK-së Haxhi Arifi, përshëndeti Kuvendin Zgjedhor të RrG, duke i dëshiruar punime të suksesshme. Njëherit edhe duke i përgëzuar për aprovimin e Ligjit të Punës, sidomos nenin 48, që ka të bëjë me pushimin e lehonave. Ai informoi delegatet edhe për reformat që është duke i bërë BSPK-ja, mbi bazë të vendimeve të Kongresit dhe KD të BSPK-së si dhe Rekomandime të ITUC-ut të vitit 2007 dhe 2010, që nënkupton edhe mbajtjen e Kuvendeve (Kongreseve) Zgjedhore të SP-ve si dhe Kuvendeve Zgjedhore të RrG dhe RrR të BSPK-së. Kuvendi pasi zgjodhi trupat punuese dhe miratoi Rregulloren e Punës zgjodhi udhëheqjen e Rrjetit, edhe atë kryetare Dr. Igballe Malushaj, ndërsa nënkryetare: Fatmire Ulaj dhe Ganimete Dumani.

**Zyra për Informim, BSPK  
Fatma Rastelica**

**Kryetari i BSPK-së  
Haxhi Arifi**